

Parashtrimi
i kërkesës

tuaj
në

Gj

E

D

Nj



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Parashtrimi i kërkesës tuaj në GJEDNJ:

Si të parashtroni kërkesën
dhe si procedohet
me kërkesën tuaj

Ky dokument është përgatitur nga Zyra për Marrëdhëniet me Publikun e Gjykatës. Dokumenti nuk e obligon ligjërisht Gjykatën. Qëllimi i tij është që të ofroj informata të përgjithshme elementare për mënyrën se si funksionon Gjykata.

Për informacion më të hollësishëm duhet referuar dokumenteve të publikuara nga Sekretariati i Gjykatës (që gjenden në ueb-faqen e Gjykatës: www.echr.coe.int) dhe në veçanti Rregullores së Gjykatës.

Pjesa më e madhe e kërkesave të parashtruara në Gjykatë shpallen si të papranueshme, që do të thotë se Gjykata i hedh poshtë ato madje pa shqyrtuar themelin e çështjes, për shkak se kërkesa nuk i përmbush të gjitha kriteret e pranueshmërisë. Vendimet për shpalljen e kërkesave të papranueshme janë të formës së prerë dhe nuk mund të apelojnë.

Prandaj, nëse nuk dëshironi që Gjykata të refuzojë kërkesën tuaj, është me rëndësi që të përmbushni të gjitha kriteret e pranueshmërisë. Para se të parashtroni kërkesën tuaj, ju lutemi që të konsultoni ueb-faqen e Gjykatës, posaçërisht Udhëzuesin për Pranueshmëri, dhe të plotësoni listën kontrolluese për t'u siguruar që kërkesa juaj të ketë shansin e kalimit të fazës së pranueshmërisë.

DËSHIRONI TË PARASHTRONI KËRKESË NË GJYKATË

Formulari i kërkesës është në dispozicion në ueb-faqen e Gjykatës. Shkarkoni dhe plotësoni çdo pjesë të formularit, pa përjashtim, dhe dërgojeni në Gjykatë së bashku me kopjet e të gjitha dokumenteve relevante – **jo** origjinalet, pasi ato nuk do t'ju kthehen pas përfundimit të procedurave. Mos e kontaktoni Gjykatën për kopjen fizike të formularit; printimi i formularit nga ju do të kursejë kohë dhe kujdesuni që kërkesa juaj të arrijë në Gjykatë me kohë (konsultoni Udhëzuesin e Praktikave për rregullat e procedimit të kërkesës dhe njoftimin që shpjegon se si të plotësoni formularin e kërkesës, i cili ndodhet në ueb-faqen e Gjykatës).

Nëse kërkesa juaj është e pakompletuar ekziston rreziku që Gjykata të mos e shqyrtojë atë, prandaj është thelbësore që të plotësoni me kujdes çdo pjesë të formularit të kërkesës. Nëse vetëm një pjesë e formularit nuk është e plotësuar si duhet ose mungon ndonjë informatë, apo nuk keni përfshirë kopjet e duhura të dokumenteve, Gjykata mund të refuzojë të regjistrojë kërkesën tuaj pa e shqyrtuar fare.

Ju mund të parashtroni kërkesën në Gjykatë në njërën nga dy gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës – në gjuhën frenge dhe në gjuhën angleze – apo në gjuhën zyrtare të çdo shteti anëtar të Këshillit të Evropës.

Ju nuk jeni të detyruar që të përfaqësoheni nga ndonjë avokat në fillim të procedurës. Megjithatë, nëse vendosni të shfrytëzoni shërbimet e avokatit, ju duhet t'i dërgoni me kohë Gjykatës dokumentin e nënshkruar me të cilin të autorizoni avokatin tuaj që t'ju përfaqësojë në Gjykatë.

Pasi të keni plotësuar çdo pjesë të formularit të kërkesës, dërgojeni në adresën në vijim, bashkë me kopjet e dokumenteve të nevojshme:

**The Registrar
European Court of Human Rights
Council of Europe
67075 Strasbourg cedex
France**

Është e preferuar që kërkesën tuaj ta dërgoni me letër të regjistruar. Ju duhet ta dërgoni atë brenda katër muajve prej datës së vendimit të fundit nga gjykataat kombëtare. Data të cilën Gjykata e merr parasysh është data e pullës postare në kërkesën e dërguar nga ju. **Ju lutem kini parasysh se kërkesat mund të dërgohen vetëm përmes postës.**

Në çdo rast, ju këshillojmë fuqishëm që të dorëzoni kërkesën tuaj **sa më shpejt që të jetë e mundur**, pasi procedurat në rang vendi të kenë përfunduar me vendim përfundimtar gjykate.

JU TANI KENI DORËZUAR KËRKESËN TUAJ NË GJYKATË

Kërkesa juaj do të arrijë në Zyrën Qendrore të Gjykatës, e cila pranon rreth 1500 letra çdo ditë. Duke qenë se vijnë kaq shumë letra, Gjykata nuk mund të konfirmojë menjëherë pranimin e kërkesës tuaj.

Mos telefononi në Gjykatë për të verifikuar nëse kërkesa juaj ka mbërritur. Gjykata do t'ju kontaktojë nëse ka nevojë për më shumë informacion.

Zyra Qendrore bën klasifikimin e postës dhe e dërgon kërkesën tuaj tek departamenti ligjor që ka për detyrë të merret me të, përkatësisht tek departamenti ligjor përgjegjës për shtetin kundër të cilit është parashtruar kërkesa. Për shembull, një kërkesë kundër Gjermanisë do të dërgohet në departamentin ligjor i cili merret me çështjet gjermane, për shkak se njerëzit që punojnë në atë departament flasin gjuhën gjermane dhe kanë njohuri për legjisllacionin vendas.

Lëndës tuaj pastaj do t'i caktohet një numër dhe do të shqyrtohet nga një jurist. Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se Gjykata e ka pranuar kërkesën tuaj; kjo vetëm nënkupton se ajo është regjistruar. **Nëse Gjykata ju kontakton, ju duhet të përgjigjeni brenda afatit të specifikuar, përndryshe dosja juaj thjesht mund të refuzohet ose të asgjësohet.**

Pasi Gjykata të ketë marrë të të gjithë informacionin që i duhet për të shqyrtuar çështjen tuaj, kërkesa juaj do t'i caktohet njërit nga trupat gjyqësore të Gjykatës.

Gjatë procedurave gjyqësore, edhe pse mund të duket se po marrin shumë kohë, duhet të prisni që t'ju kontaktojë Gjykata. Për shkak të numrit të madh të kërkesave që pranon çdo vit (mbi 50000) dhe numrit edhe më të madh të kërkesave në procedurë, Gjykata nuk mund të konfirmojë marrjen e letrave dhe të dokumenteve që pranon, ose t'ju tregojë se kur përafërsisht do të shqyrtohet çështja juaj.

Procedurat në Gjykatë bëhen në formë të shkruar. Çdo informacion për të cilin ju dëshironi ta vini Gjykatën në dijeni, duhet dorëzuar me shkrim.

SHQYRTIMI I KËRKESËS TUAJ

1. TRUPAT GJYQËSORE

Pasi Gjykata të ketë marrë të gjithë informacionin që i duhet për të shqyrtuar çështjen tuaj, kërkesa juaj do t'i caktohet njërit nga trupat gjyqësore të Gjykatës, në varësi të llojit të çështjes: një gjyqtari të vetëm, një Komiteti ose një Dhomë.

- ➔ Nëse kërkesa juaj është qartazi e papranueshme për shkak se nuk i plotëson të gjitha kriteret për pranueshmëri, ajo do të trajtohet nga trupi gjykues i përbërë nga **një gjyqtar**. Vendimi për papranueshmëri i dhënë nga ai gjyqtar do të jetë përfundimtar dhe ju do të informoheni për të. **Nuk mund të apelohej vendimi për papranueshmëri apo të kërkohen më shumë informata rreth tij. Gjykata do të mbyllë çështjen dhe dosja juaj do të asgjësohet në një datë të mëvonshme.**
- ➔ Nëse çështja e juaj konsiderohet si çështje e përsëritur, e cila ngre një problem për të cilin Gjykata ka marrë vendim më herët, atëherë ajo do të trajtohet nga **Komiteti prej 3 gjyqtarësh**. Në këtë rast, do t'ju dërgohet një letër e cila ofron sqarime për procedurën. **Përsëri, Gjykata do t'ju kontaktojë, nëse dhe kur është e nevojshme.**
- ➔ Nëse çështja juaj nuk konsiderohet të jetë çështje e përsëritur, ajo do të shqyrtohet nga **Dhoma prej 7 gjyqtarësh**. Dhoma edhe më tutje mund të shpallë çështjen të papranueshme, dhe nëse e bën këtë vendim do të jetë i formës së prerë, por nëse e vlerëson çështjen si të pranueshme ajo do të shqyrtojë themelin e çështjes tuaj. Megjithatë, para se ta bëjë këtë, së pari do të njoftojë Qeverinë e paditur për kërkesën, me qëllimin për ta informuar për praninë e kërkesës dhe për t'i mundësuar që të dorëzojë vërejtjet e saj për çështjen e kontestuar. Këto vëzhgime pastaj do t'ju dërgohen juve, për t'u dhënë mundësinë që të përgjigjeni. Ndonëse nuk jeni të detyruar që të përfaqësoheni nga një avokat në fillim të procedurës, në këtë fazë Gjykata do t'ju ftojë që të përdorni një avokat. **Përsëri, është Gjykata ajo që do t'ju kontaktojë ju.**

- ➔ Për informacionin tuaj, asnjë kërkesë nuk dërgohet ndonjëherë drejtpërdrejtë në **Dhomën e Madhe me 17 gjyqtarë**, por një Dhomë mund të heqë dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe ose një çështje mund t'i kalohet për shqyrtim në një fazë më të avancuar të procedurës. Heqja dorë është e mundur atëherë kur një çështje ngre një pyetje serioze që ndikon në interpretimin e Konventës apo nëse ekziston rreziku i mospërputhjes me një vendim të mëhershëm të Gjykatës. Po ashtu, një çështje mund të referohet për shqyrtim në Dhomën e Madhe me kërkesë të secilës palë, brenda 3 muajsh pas shpalljes së aktgjykimit të Dhomës, por Gjykata pranon kërkesa të tilla vetëm në raste përjashtimore.

2. SA KOHË ZGJAT PROCESI?

Nuk mund të thuhet se sa kohë mesatarisht do t'i duhet Gjykatës për të shqyrtuar një kërkesë. Kjo varet nga lloji i çështjes, trupi gjykues të cilit i është caktuar çështja, sa shpejt do t'i ofrojnë palët Gjykatës informacionin që i duhet dhe nga shumë faktorë të tjerë. **Gjykata i shqyrton kërkesat sipas një rendi të caktuar, që merr parasysh rëndësinë dhe urgjencën e çështjeve të përfshira.** Kjo do të thotë se, për shembull, rastet më serioze apo ato që shpërfaqin praninë e problemeve në masë më të madhe do të trajtohen me prioritet, që edhe shpjegon se pse për një kërkesë që është parashtruar më vonë se e juaja mund të merret vendimi, ndërkohë që çështja juaj ende pret për t'u shqyrtuar në Gjykatë.

3. SEANCAT

Gjykata zhvillon seanca për një numër të vogël të çështjeve të Dhomës apo të Dhomës së Madhe (rreth 30 të tilla çdo vit). Nëse vendos për të zhvilluar seancë rreth çështjes tuaj, ju do të informoheni për këtë. Të gjitha seancat regjistrohen dhe mund shikohen në ueb-faqen e Gjykatës.

FUNDI I PROCEDURËS

Gjykata mund të mbyll çështjet në mënyra të ndryshme.

1. KËRKESA REFUZOHET

➔ DOSJA ASGJËSOHET

Nëse në fillim të procedurave Gjykata ju kontakton dhe ju nuk përgjigjeni fare ose nuk përgjigjeni brenda afatit të parashikuar, Gjykata mund të nënkuptojë se ju nuk dëshironi që të vazhdoni çështjen më tutje dhe vendos të mbyllë çështjen. Dosja juaj do të asgjësohet dhe ju nuk do të keni të drejtë ta apelonit atë vendim.

➔ ÇËSHTJA FSHIHET NGA LISTA E GJYKATËS

Në një fazë më të vonshme të procedurave, pasi kërkesa juaj t'ji jetë caktuar një trupi gjykses, Gjykata mund ta fshijë atë nga lista nëse ju nuk përgjigjeni në kërkesat e saj brenda afatit të parashikuar; Gjykata mund ta kuptojë këtë sikur ju nuk dëshironi që çështja juaj të vazhdojë më tutje. Gjykata po ashtu mund të fshijë një kërkesë nga lista e saj pas arritjes së zgjidhjes miqësore apo deklaratis së njëanshme.

Prandaj është e domosdoshme që ju t'ji përgjigjeni Gjykatës pa asnjë vonesë. Kjo do të sigurojë që ju të mos konsideroheni si një parashtrues i cili nuk është i interesuar në vazhdimin e kërkesës së tij/saj dhe që Gjykata të mos e fshijë kërkesën tuaj nga lista e saj apo të mbyllë dosjen.

➔ ÇËSHTJA SHPALLET E PAPANUESHME

Nëse nuk plotësoni ndonjë nga kriteret e Gjykatës për pranueshmëri, atëherë Gjykata do të shpallë kërkesën tuaj të papranueshme dhe ky vendim do të jetë përfundimtar.

2. JEPET AKTGYJKIMI

Nëse kërkesa juaj nuk është shpallur e papranueshme, pas shqyrtimit të kërkesës Gjykata mund të gjejë se nuk ka pasur ndonjë shkelje të Konventës, apo të kundërtën, se të drejtat tuaja janë shkelur. Nëse gjen shkelje, Gjykata mund t'ju caktojë kompensim. Megjithatë, kini parasys se, në asnjë rrethanë Gjykata nuk do të injorojë një vendim të gjykatës vendase.

Nëse vendimi jepet nga një Komitet, ai është përfundimtar dhe nuk mund të apelohej. Një vendim i Dhomës bëhet përfundimtar 3 muaj pas shpalljes së tij. Gjatë këtyre 3 muajve, ju apo Qeveria e paditur mund të kërkonin që çështja të kalohet për shqyrtim të ri në Dhomën e Madhe. Mbani mend se, Gjykata pranon kërkesa të tilla për kalim të çështjes për shqyrtim në Dhomën e Madhe vetëm në raste përjashtimore. Vendimet e Dhomës së Madhe janë përfundimtare dhe nuk mund të apelohej.

Pasi një vendim që gjen shkelje bëhet përfundimtar, Gjykata ia përcjell dosjen Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, që është përgjegjës për monitorimin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës. Kjo i jep fund procedurës në Gjykatë.

Për të konkluduar, është me rëndësi që të përmbushni kriteret e pranueshmërisë kur parashtroni kërkesën në Gjykatë. Nëse ju dështoni ta bëni këtë, Gjykata do të detyrohet që të refuzojë kërkesën tuaj pa shqyrtuar ankesat që keni.

Për më shumë, pasi që Gjykata të shpallë një kërkesë të papranueshme, ai vendim është përfundimtar dhe ju nuk do të mund të rihapni çështjen tuaj apo të parashtroni një kërkesë të re që përmban të njëjtën ankesë.

GJËRA ME RËNDËSI PËR T'Ë DITUR

■ ANONIMITETI

Dokumentet që kanë të bëjnë me procedurën në Gjykatë janë në dispozicion të publikut. Nëse dëshironi që të mbeteni anonim, ju duhet ta kërkonti këtë kur të plotësoni formularin e kërkesës dhe të sqaroni pse nuk dëshironi që identiteti tuaj të zbulohet.

■ ZGJIDHJA MIQËSORE

Nëse Gjykata e konsideron kërkesën tuaj të pranueshme ajo do të bëjë përpjekje për të arritur një marrëveshje – një zgjidhje miqësore – ndërmjet jush dhe Qeverisë së paditur. Nëse kjo dëshmohet e pamundur, ajo do të shqyrtojë ankesat tuaja dhe do të japë një vendim.

■ DEKLARIMET E NJËANSHME

Nëse ju refuzoni ofertën për një zgjidhje miqësore pa arsyetim, Gjykata mund të fshijë kërkesën tuaj nga lista e saj, pas deklaratës së Qeverisë së paditur që pranon se ka pasur shkelje të Konventës dhe përpjekjeve për t'ju ofruar një dëmshpërblim të përshtatshëm.

■ MASAT E PËRKOHSHME

Ju mund të kërkonti masë të përkohshme, por vetëm nëse jeni në rrezik të drejtpërdrejtë apo nëse ekziston kërcënimi serioz për shëndetin tuaj – për shembull, nëse ju do të dërgoheni në një vend ku ekziston rreziku që të torturoheni.

PYETJET MË TË SHPESHTA

■ NËSE UNË PARASHTRON KËRKESËN NË GJYKATË, A DO TË THOTË KJO QË NUK DUHET T'Ë BINDEM VENDIMIT PËRFUNDIMTAR TË SHPALLUR NGA GJYKATAT VENDASE?

Jo, parashtrimi i kërkesës në Gjykatë nuk ka efekt pezullues. Ju duhet t'ë bindeni vendimeve përfundimtare të gjykatave vendase edhe nëse parashtroni kërkesën në Gjykatën e Strasburgut.

■ A MUND TË MË NDIHMOJË GJYKATA TË GJEJË NJË AVOKAT?

Jo, Gjykata nuk mund t'ë ndihmojë të gjeni një avokat. Për shembull, ju mund të kontaktoni Dhomën e Avokatëve në vendin tuaj dhe të kërkonti një listë të anëtarëve të tyre.

■ A MUND TË MË NDIHMOJË GJYKATA NË PLOTËSIMIN E FORMULARIT TË KËRKESËS?

Jo, Gjykata nuk mund t'ë ndihmojë me formularin e kërkesës. Gjykata duhet të mbetet neutrale në të gjitha procedurat e inicuar para saj. Prandaj, gjithçka që mund të bëjë është që t'ë referojë në udhëzuesin për aplikim, të cilin mund ta gjeni në internet dhe i cili përmban të gjitha dokumentet dhe informatat që ju duhen për të parashtruar një kërkesë.

■ A KA SISTEM TË NDIHMËS LIGJORE?

Po. Sidoqoftë, ju nuk mund të kërkonti ndihmë ligjore në fillim të procedurës, por vetëm pasi çështja t'ë jetë komunikuar Qeverisë së paditur. Dhe ju lutemi të keni parasysh se, ndihma ligjore nuk iu miratohet në mënyrë automatike të gjithë atyre që e kërkojnë atë.

■ NËSE UNË SHKOJ PERSONALISHT NË GJYKATË, A MUND TË SHPJEGOJ ÇËSHTJEN TIME DREJTPËRDREJT APO TË BËJ NDNJË GJË QË TË SHQYRTOHET MË SHPEJT?

Sigurisht që jo. Procedurat në Gjykatë bëhen me shkrim dhe vajtja juaj në Gjykatë nuk i shërben asnjë qëllimi të dobishëm. Është humbje e kohës tuaj.

■ **A MUND TË MË OFROJË GJYKATA KËSHILLA LIGJORE?**

Nuk është përgjegjësi e Gjykatës që t'ju ofrojë këshilla ligjore për procedurat apo hapat që ju duhet të ndërmerrni në vendin tuaj. Për sa i përket procedurave në Gjykatën e Strasburgut, çdo gjë është e shpjeguar hollësisht në dokumentet me informacion që mund t'i gjeni në ueb-faqen e Gjykatës. Gjykata nuk mund t'ju tregoj sa gjasa për sukses ka kërkesa juaj; ju thjesht duhet të prisni atë që të marrë një vendim apo të shpallë aktgjykimin.

■ **A MUNDET GJYKATA TË NDËRMARRË NDONJË VEPRIM NË SHTETIN KUNDËR TË CILIT UNË PARASHTRON KËRKESËN?**

Jo. Gjykata nuk do të ndërmarrë asnjë veprim në emrin tuaj përballë autoriteteve kundër të cilëve ju parashtroni ankesën. Megjithatë, në raste përjashtimore, ajo mund të kërkojë nga autoritetet vendase që të ndërmarrin masat e caktuara apo të mos bëjnë gjëra të caktuara, për derisa ajo të ketë shfrytëzuar rastin që të shqyrtoj çështjen (kjo vlen kryesisht për rastet kur parashtruesi përballet me rrezikun e cenimit serioz fizik).

■ **A ËSHTË PËRBALLUR GJYKATA ME RASTE TË TJERA SI I IMI?**

Vendimet e Gjykatës publikohen në ueb-faqen e saj. Ju mund të kërkonti vendimet ekzistuese për të parë nëse Gjykata ka shqyrtuar ndonjë rast të ngjashëm me tuajin.

■ **NËSE KËRKESA IME ËSHTË SHPALLUR E PAPANUESHME, A MUND TA ANKIMOJ ATË VENDIM?**

Vendimet për papranueshmëri janë përfundimtare dhe nuk mund të ankimohen. Kjo tregon se është me rëndësi që parashtruesit të sigurohen që ata të përmbushin të gjitha kriteret e pranueshmërisë para se të paraqesin kërkesën në Gjykatë.

■ **SI MUND TË SIGUROJ INFORMACION PËR ÇËSHTJEN TIME?**

Gjykata nuk mund t'u përgjigjet të gjitha kërkesave që merr për informacion në lidhje me progresin rreth çështjeve që priten për t'u zgjidhur. Duke qenë se procedurat në Gjykatë bëhen me shkrim, Gjykata do t'ju shkruajë nëse ka nevojë për informata shtesë apo në faza të ndryshme të procedurave. Informatat mund të gjenden edhe në ueb-faqen e saj (në lidhje me komunikimin, pyetjet ndaj palëve, vendimet për pranueshmëri dhe informata të tjera).

Parashtrimi i kërkesës tuaj në GJEDNJ:

Si të parashtroni kërkesën dhe
si procedohet me kërkesën tuaj



European Court of Human Rights
Council of Europe
67075 Strasbourg cedex
France

www.echr.coe.int